



Pranuar / Dorectuar Priljena/Prodato Received/Delivery	25-11-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMBASTIK	7424/2022		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.860/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga; Arben Mehmeti kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 860/2022, të datës 04.10.2022 të ankuesit me adresë banimi nga kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, neni 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.11.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.860/2022 e datës 04.10.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicoj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të pagës, nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin shtatë (7) .

III. Detyrohet Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të ndërmerr veprimet konformë përgjegjësiive ligjore sipas Pikës II të këtij vendimi.



IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] me datë 04.10.2022, ka parashtruar ankesën me numër protokolli 5878/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për harmonizimin e koeficientit nga gjashtë (6), në koeficientin shtatë (7).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ndërsa me datë 20.10.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vendosjes meritore ka administruar provat si në vijim; për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr 860/2022, datës 04.10.2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për ngritjen e koeficientit e datës 02.09.2022 me numër protokolli 6014/2022; E-maili i datës 17.08.2022; Vendosje e koeficienteve e datës 27.11.2014; Akt Emërimi i datës 17.01.2012; E- maili i datës 20.09.2022; E- maili i datës 03.10.2022; Lista e pagave e datës 01.08.2022, deri me datë 31.08.2022; Përgjigje në kërkesë e datës 16.09.2022; Kërkesë e datës 04.10.2010; Kontrata e punës e datës 01.10.2010; ; Kontrata e punës e datës 01.12.2007; Kontrata e punës e datës 01.12.2005; ; Kontrata e punës e datës 01.12.2003; Kontrata e punës e datës 01.11.2002; Plani i punës; Përshkrimi i detyrave të Punës; e- maili i datës 14.09.2022; e- maili i datës 19.09.2022; Diplomë e datës 30.08.2019; kërkesë e datës 04.10.2010; Konkursi i datës 18.10.2022; Konkursi i datës 05.09.2022 Përgjigje në ankesë e datës 20.10.2022, me numër protokolli 6325/2022 bashkë me shkresat e bashkangjitura; kopja e konkursit e datës 17.02.2015 dhe Akt emërimi i datës 27.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuses, *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rezulton se ankuesi sipas Kontratës së marrëdhënies së punës me Nr. 00015 të datës 08.10.2002 ka qenë i punësuar në pozitën Nëpunës për furnizim në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor deri më datë 01.10.2010 kur merr pozitën Zyrtar për pranimin e mallit të cilën pozitë e mbanë edhe tani sipas Akt emërimit të 08.07.2014 me koeficient të pagës gjashtë (6).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka konstatuar së ankuesi me datën 02.09.2022 ka parashtruar kërkesë për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për ngritje të koeficientit nga gjashtë(6) në shtatë (7), të njëjtën kërkesë ankuesi e ka përsëritur me datën 16.09.2022, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës kërkesën e ka adresuar tek Divizioni i Burimeve Njerëzore. Udhëheqësja e



Burimeve Njerëzore me datën 16.09.2022 i është përgjigjur ankuesit lidhur me kërkesën e datës 02.09.2022 me numër protokollit 6014 me arsyetimin se : *me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114, për Zyrtaret Publik, kompetenca e shpalljes së konkurseve sipas nenit 34 paragrafi i takon Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik( DMZP) siç përcaktohet se : "3. Konkurrini organizohet nga DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore për çdo institucion tjetër (në tekstin në vijim: njësia përgjegjëse)", për pozitën profesionale, qoftë edhe me ngritje të koeficientit bëhet me konkurs, po ashtu udhëheqësja e Personelit thotë se ngritja e koeficientit pas diplomimit nuk ka qenë e mundur se i njëjti ka diplomuar në vitin 2019, pasi që është kërkuar përvoja profesionale pas diplomimit. Andaj me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114, për Zyrtaret Publik, të gjitha kompetencat kanë kaluar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përkatësisht në DMZP dhe asnjë ngritje e koeficientit nuk është pranuar nga Ministria e Punës, Financave dhe Transfereve pa pasur procedurë të konkurrimit.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që t'i bëhet harmonizimi i koeficientit sipas pozitës që mban në raport me pozitën e njëjta në kuadër të njëjtë institucion pasi i njëjti këshillit i ka siguruar dëshmi ku argumentohet se për të njëjtën pozitë ,zyrtarë tjetër me të njëjtën pozitë paguhet me koeficient të tjetër, përkatësisht zyrtari, z.L.N i cili është pranuar me konkursin e shpallur me datën 17.02.2015 ,ka koeficient shtatë(7) sipas aktemrimit të datës 29/04/2015.

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejt lidhur me këtë çështje juridike-administrative, po ashtu ka analizuar edhe Katalogun e Vendeve të punës për shërbyesit civilë i miratuar me datë 05.02.2015 dhe i ndryshuar dhe plotësuar me datë 21.02.2018, nga ka konstatuar se pozita "Zyrtar për pranimin e mallrave ", është paraparë niveli profesional 2 grada 9 me koeficient 7.

Rrjedhimisht, në funksion të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji ju referua Nenit 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar së: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave",* ndërsa ndërlidhur me këtë neni 9 paragrafi 1 i Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësive Civil, përcakton se: *"Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kontratës së punës".* Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji i Këshillit konstaton se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës, kështu që mbi këtë bazë ligjore dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi realizon koeficientin e pagës të përcaktuar sipas Akt emërimit të datës 08.07.2014 me koeficient gjashtë (6).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar provat e poseduara nga ankuesi dhe organi i punësimit, duke marrë për bazë edhe çështjen e arsimimit për këtë pozitë konstaton se në bazë të shkresave të lëndës ankuesi posedon Diplomën e datës 30.08.2019 me nr. 336/19 e lëshuar nga Kolegji Iliria, ku i njëjti ka përfunduar "Baçelor i Arteve në Banka, Financa dhe Kontabilitet", i cili ka diplomuar me datë 26.09.2019 ,rrjedhimisht i njëjti plotëson edhe kriterin e arsimimit për pozitën e njëjtë dhe përvojën e punës pas diplomimit dhe në këtë kuptim pretendimi është i bazuar.



Ndërlidhur me pretendimin ankimor si më lartë, Kolegji duke u bazuar në provat e lëndës ka gjetur se ankuesi ka paraqitur argumentin me që rast krahason pozitën aktuale që e mban me koeficient gjashtë(6), me pozitën e zyrtarit z.L.N i cili ka të njëjtën pozitë por me koeficient shtatë(7), ndërsa edhe pse ankuesi mban pozitë të njëjtë i njëjti paguhet me koeficient të pagës gjashtë (6), andaj edhe në këtë kuptim pretendimi për diskriminim është i bazuar.

Në bazë nenit 6 paragrafit 5 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe nenit 16 të Rregullores Nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës janë përcaktuar gradat për pozitat e nivelit profesional të cilat fillojnë nga tetë (8) deri në dhjetë (10), ndërlidhur me këtë, si dhe bazuar në nenin 34 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore kanë qenë të detyruar që të bëjnë klasifikimin, harmonizimin dhe standardizimin e pozitave në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.

Andaj, nisur nga gjendja faktike dhe juridike e konstatuar si më lartë, Kolegji vlerëson se organi i punësimit gjegjësisht Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me rastin e mos harmonizimit të koeficientit të pagës së ankuesit ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *“Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë”*, kështu që Kolegji vlerëson se është i bazuar pretendimi ankimor i ankuesit mbi bazën e harmonizimit të koeficientit të pagës, rrjedhimisht institucioni duhet të sigurojë që konform legjislacionit përkatës të mos ketë trajtim jo të barabartë ndërmjet nëpunësve civil nga se kjo është në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, sepse institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë, siç parashihet me nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë.

Nga sa u tha më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se organi i punësimit konkretisht Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, janë të obliguar që konform këtij vendimi dhe dispozitave ligjore në fuqi të ndërmarrin veprimet administrative që të bëjë harmonizimin e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në shtatë (7).

Theksuar si me lart, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh,

nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.860/2022, datë 25/11/2022.

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-L.O; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.